



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 49/2016

Prishtinë, më 08.03.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Isa Krasniqi – Kryeshef ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Sokol Havolli – Këshilltar ZKM; Ruud Vermeulen – FMN; Agim Demukaj – BB; Arben Mustafa – BQK; Semra Tyrbedari - Çitaku – MF.

Pjesëmarrës të tjerë: Ilir Berisha – ASK; Valentin Toçi – ZKM; Selim Thaçi – FMN; Bedri Zymeri; Fjolla Uka – KDI; Visar Berisha – INDEP; Arlinda Bajrami – GAP dhe Evlina Kabashi – Praktikante e Komisionit.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.02.2016;
3. Shqyrtimi i informatës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës, lidhur me publikimin e statistikave për rritjen ekonomike, investimet, punësimin dhe prodhimin industrial;
4. Aktivitetet vijuese të Komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.02.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 23.02.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i informatës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës, lidhur me publikimin e statistikave për rritjen ekonomike, investimet, punësimin dhe prodhimin industrial

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa tha se kjo është një mbledhje e zgjeruar e komisionit, ku kemi përfaqësues të Agjencionit për Statistikat e Kosovës, z. Isa Krasniqi dhe z. Ilir Berisha, kemi përfaqësues nga Zyra e kryeministrit, z. Sokol Havolli dhe z. Valentin Toçi, kemi edhe përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, z. Ruud Vermueler, kemi edhe pjesëmarrjen nga Banka Botërore, z. Agim Demukaj, pastaj nga BQK-ja kemi z. Bedri Zymeri dhe z. Arben Mustafa, si dhe znj. Semra Tyrbedari – Çitaku, nga njësia për analiza makro-ekonomike në Ministrinë e Financave. Duke u nisur nga nevojat që politikat ekonomike edhe politikat zhvillimore të jenë të bazuara në statistika të publikuara me kohë dhe gjithëpërfshirëse, sidomos në çështjet kryesore të qeverisjes makro-ekonomike, pra që ndërlidhen me rritjen makro- ekonomike, me investimet me punësimin dhe prodhimin brenda industrisë, ne kemi menduar që është mirë që të trajtojmë problemet se deri ku kemi arritur në përgatitjen e publikimeve në këtë fushë dhe çfarë duhet të jenë masat e më tutje për të rritur numërin edhe frekuencën, si dhe përmbajtjen e këtyre publikimeve që kanë të bëjnë me këta sektorë të rëndësishëm. Janë bërë disa avansime, sidomos me publikimin e GDP-is, rritja ekonomike në qoftë se llogaritet në bazë të shpenzimeve, por edhe në bazë të të gjithë sektorëve dhe veprimtarive kemi shënuar një avansim kohën e fundit. Megjithatë ne ende presim atë avansim në këtë drejtim, publikimin e vlerësimeve për çdo tremujor lidhur me ecurinë e GDP-is d.m.th. prognoza ende nuk kemi të tilla, por ajo e cila është shumë me rëndësi, e që ne ende nuk mund ta shohim nga publikimet që ka ende të bëjnë me prodhimin industrial dhe shërbimeve. Gjithashtu kemi të bëjmë edhe me punësimin, ne kemi edhe vlerësimet e papunësisë, por nuk kemi statistika të cilat na tregojnë se sa njërëz hyjnë në punë brenda një viti, dhe në cilin sektor hyjnë në punë, cilët janë ata sektorë që po gjenerojnë vende të punës. Po ashtu investimet i kemi më tepër të involvuara më tepër se sa sektorët aktual dhe nese i merrni këto vonesat e konsiderueshme në publikimin e rritjes ekonomike në bazë të bruto produktit vendor - GDP-is dhe mungesën e publikimeve për këta sektorë shumë të rëndësishëm, sektorin e prodhimit, sektorin e punësimit, sektorin e investimeve, atëherë nuk është vështirë që të konstatojnë se krijuesit e politikave në Kosovë më të vërtetë operojnë me të dhëna të cilat nuk janë të plota dhe të cilat është e vështirë që të projketohen edhe rritjet ekonomike, levizjet në këta sektorë, por edhe gjithashtu të udhëheqin politika aktive industriale të gjenerimit të punësimit.

Isa Krasniqi, Agjencia për Statistika të Kosovës – (ASK), më lejoni që në fillim që ta përshendes këtë ftesë për pjesëmarrje në këtë komision të këtij niveli kaq të lartë që tregon që është një përkushtim, që besoj jo vetëm për këto statistika, por në përgjithësi për të gjitha statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës. Fillimisht dëshiroj të potencojë, sistemin statestikor të Kosovës në kuptimin e prodhimit statestikor, apo aktorët që bëjnë pjesë në të është Agjencia Statistikore e Kosovës, prodhues të tjerë është edhe Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Kosovës, dhe prodhues të tjerë të cilët marrin leje nga Agjencia Statestikore e Kosovës konform ligjit të statistikave zyrtare. Me nënshkrimin e marrëveshjes të MSA të Kosovës dhe BE-së një rëndësi e veçantë i është dhënë në kuadër të kësaj marrëveshje ku konkretisht është Neni 95, ku i jepet rëndësi sistemit të statsistikave të Kosovës dhe sidomos mbështetjes së Agjencisë të Statistikave të Kosovës, në të ardhmen që të kemi statistika zyrtare sa më të besueshme dhe sa më të dobishme në kuptimin e statistikës. Ekziston Ligji i statistikave zyrtare i cili është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2011, ku më përpara nuk ka pasur dhe sistemi i statistikave, ka qenë paksa i shpërndarë në kuptimin e roleve përmes rregulloreve të UNMIK-ut. Që nga viti 2012, gjithçka që është vepruar në sistemin e statistikave të Kosovës, është rregulluar sipas Ligjit ekzistues të statistikave zyrtare. Në kuadër të Ligjit ASK-ja me kohë, kuptohet me ndihmën edhe të donatorëve të ndryshum, ka draftuar programin pesëvjeçar strategjik 2013-2017, i cili në atë kohë është aprovuar edhe nga Qeveria e Kosovës edhe ne funksionojmë në bazë të këtij programi strategjik pesëvjeçar. Në kuadër edhe të statistikave zyrtare, por edhe të Ligjit planifikohen, statistikave të prodhimit statestikore sipas dispozitave ligjore edhe publikimet, kalendarët e publikimeve. Paraprakisht, ne i vendosim në web- faqen të gjitha publikimet të cilat janë të planifikuara. Në kuptimin e projekteve këtu realizimi i tyre, të dhënat që i kanë munguar për një kohë shumë të gjatë për llogaritjen e shumë të dhënave të tjera, sepse gjithçka varet edhe nga numri i popullsisë në kuptimin e kalkulimeve. Pra, ky projekti i regjistrimit të popullsisë, është një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm, është realizuar në vitin 2011, por edhe në vitin 2014, ku më shumë se 50 vjet nuk është bërë dhe tani kemi të dhëna të cilat janë bërë edhe për bujqësi në Republikën e Kosovës. Ne po i përmendim vetëm projektet e mëdha pasi që kemi pasur shumë projekte të tjera të cilët ndërlihdën edhe me indikatorët e tjerë. Këtu është një projekt i cili është zhvilluar me UNICEF-in, që është një anketë e grupimeve të treguesve të shumëfishtë, dhe është në nivel të minoriteteve të komunitetit rom, egjiptian dhe ashkalinj. Mund të them se sfidat të cilat na kanë përcjellë deri me tani është mungesa e buxhetit, kur të krahasojmë shifrat del që diku rreth 79% kemi buxhet që është dhënë nga donatorët për Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe vetëm 21% i kemi nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, e kjo më së shumti flet lidhur për nevojat që ka Agjencia i Statistikave të Kosovës, sidomos tash në këtë periudhë që pason duke u bazuar në atë që thashë më përpara për obligimet të cilat dalin nga Kosova te marrëveshja e MSA-së. Në kuptimin e mbështetjes përveç që neve na duhet të zhvillojmë anketa për të rritur prodhuesit statestikor. Neve na duhet edhe mbështetje e rritjes së burimeve njerëzore, sepse jashtëzakonisht kemi numër më të madh të burimeve njerëzore për t'i inkuadruar ata në secilën anketë dhe në secilën publikim veç e veç, sepse duke pasur burime mund t'i prodhojmë këto statistika ashtu siç kërkohet. Një mbështetje të burimet njerëzore po e potencoj këtu kanë dhënë shumë donatorë, sidomos EUROSTAT-i pasi që kemi një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë, e cila është qendra statestikore e BE-së, dhe duke e pasur një bashkëpunim shumë të mirë me ta dhe procesi i integritimeve europiane të Kosovës EUROSTAT-i ka mbështet në vazhdimsi stafin e Agjencisë të Statistikave të Kosovës në kutpimin e trajnimeve profesionale. Në aspektin e hapësirave ndoshta ligjore, mos të themi mangësive ligjore në ligjin ekzistues në bazë të

rekomandimeve, sepse ne kemi edhe vlerësime për stafin në kuptimin profesional, në bazë të rekomandimeve nga EUROSTAT-i. Ne kemi inicuar edhe amendamentimin e Ligjit ekzistues të statistikave zyrtare, dhe ai është në proces në Qeverinë e Republikës së Kosovës për aprovim. Në aspektin e GDP-is, treguesve, pastaj të tregut të punës ka një progres, ndoshta nuk është progresi maksimal, por ka një progres sepse duke zbatuar rregulloren e 2010 kemi bashkuar shumë standarde për kërkesat të cilat dalin nga kjo rregullore dhe tashmë jemi duke e rregulluar edhe GDP-kuartale që është jashtëzakonisht e rëndësishme, që po ashtu ndihmojnë edhe në vazhdimësi edhe për vlerësimet për GDP-in në bazat vjetore. Te treguesit e tregut të punës edhe këtu më duhet të potencoj që fillimisht mbështetja ka qenë prej donatorëve në vitin 2012, sepse më përpara ka pasur metodologji dhe d.m.th. ka pasur mënyrë tjetër për të dhëna të tilla. Nga viti 2012 e këtë duke u bazuar në ndihmën të cilën e kemi pasur prej një organizate të Britanisë së Madhe, kemi filluar dhe e kemi provuar për herë të parë edhe në bazë të metodologjisë së EUROSTAT-it, kjo ka vazhduar ndër vitet 2012-2014, tashmë jemi në një proces për vitin 2015 për anketën e stafit të fuqisë punëtore. Kemi dëgjuar edhe opinione sepse ne ekzistojmë për shfrytëzuesit dhe vazhdimisht marrim opinionet e shfrytëzuesve në kuptimin e asaj që te tregu i punës, fuqia jo aktive është kaq e madhe, ne për anketime kemi angazhuar kontraktor, Ligji për prokurorimin publik patjetër na duhet me e respektuar, por ne kemi buxhetin të cilin duhet ta realizojmë dhe të funksionojmë përmes këtij Ligji. Aspektet e kontratave të veçanta që ne do të na përshtatej më së shumti që të marrim staf me kontrata të përkohëshme dhe t'i kemi ata në përgjegjësi në kuptimin e mbledhjes të të dhënave në terren do të ishte më e mira, por neve patjetër që po detyrohemi që t'i realizojmë rekomandimet e auditimeve të ndryshme.

Blerim Grainca tha se unë e përgëzoj Agjencinë e Statistikave të Kosovës për punën e deri tanishme që kanë bërë, për punën e mirë ndër vite dhe për përpjekjet që po bënë për përmirësimin e performancës. Nga e gjithë kjo, që tha zotriu më herët, arrita me kuptuar se janë dy probleme kryesore të cilat kanë penguar agjencinë, si mungesa të fondeve të mjaftueshme dhe po ashtu numri i kufizuar i stafit. Unë mendoj që njëri ndër problemet tjera është edhe mungesa e koordinimit në mes të institucioneve që prodhojnë statistika. Të gjithë ne, këtu, jemi dëshmitarë për nga puna individuale, por edhe nga puna e përbashkët të cilën e bëjmë këtu dhe shpeshëherë na vijnë statistika jo të sakta në kuptimin e asaj që burimet që do të duhej të ishin të njëjta. Ne para vetes kemi një raport tuajin dhe një kërkesë e cila i është drejtuar minsitrisë, gjegjësisht Komisionit për Buxhet dhe Financa, që unë po ju them se e kam të paqartë kërkesën për fondet shtesë, nëse në raportin tuaj thuhet se Agjencia i Punëve Sociale ofron të dhëna për çështjen e fushës sociale, kurse në kërkesën të cilën e keni bërë për punëtorë shtesë, kërkon edhe 112 mijë euro kryesisht për anketat që lidhen me statistikën sociale, tash a është problemi që nuk ka një koordinim me ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale apo duhet vërtet edhe 112 mijë euro shtesë për të mbuluar këtë sektor? Po ashtu kemi edhe te sektorët e tjerë ca shifra që ndoshta në kushte normale nuk janë të mëdha, por ne në mungesë të buxhetit në vendin tonë po na duken shifra pak si të mëdha. Po ashtu është kërkesa tjetër 280 mijë euro, për anketat për të dhënat e ekonomisë informale nëse e kemi një ministri të financave që ka disa sektor që merren me këtë çështje dhe që do të duhej të prodhonin edhe statistika të tilla edhe në ministrinë e zhvillimit ekonomik edhe të tjera. Por gjithsesi poenta e gjithë diskutimit është që koordinim më i mirë në mes të institucioneve që prodhojnë statistika duhet të ketë. Kërkoj ta dijë së cili është numri i të papunësuarve në baza gjinore d.m.th. te punësimi se sa është numri dhe përqindja e gjinisë femrore të papunësuarve dhe shpresoj që kjo statistikë të ketë përmirësim dhe të jetë si dhuratë për tetë marsin.

Besim Beqaj tha se është një nga temat jashtëzakonisht të rëndësishme me të cilat ne ballafaqohemi, nuk do mend që Agjencia i Statistikave të Kosovës ka bërë një punë të mirë dhe që ka pasur përkrahje, qoftë nga donatorët bilateralë, qoftë nga mekanizmat e tjerë, dhe ka prodhuar statistika. Nuk mund të themi se nuk prodhohet statistikë në Kosovë, por që realisht kjo statistikë është mjaft e shkëputur. Unë këtu e shoh problemin e statistikave dhe nuk e shoh te numri i publikimeve, nuk e shoh te titujt e publikimeve, por e shoh te shkëputjet dhe mos komunikimin e statistikave, respektivisht mos prioritizimin e statistikave të cilat duhet të prodhohen këtu është shqetësimi im, tha zoti Beqaj. Sepse prodhojmë statistika të cilat sigurisht që janë të rëndësishme shumë, por që ka statistika që nuk i prodhojmë të cilat janë shumë më të rëndësishme dhe ne në këtë vend mund të bëjmë gjëra të mira me më pak para dhe dhe nuk mund të ankohet statistika, sepse disa donacione kur janë dhënë janë dhënë në fokusin e bashkëpunimit ndërshtetëror që ka pasur me dikë në bashkëpunim bilateralë. Dhe, që nuk mundemi me thënë që na ka dhënë donacion dikush, ndërsa Qeveria nuk na ka dhënë. Sepse Qeveria, buxheti, donacionet bilaterale, shpërndahen simbas nevojave dhe duhet të konsiderohet që edhe mjetet e donacionit janë kontribut i shtetit, nuk janë kontribut i individëve. Po e zëmë në vitin 2014 ne e kemi bërë në Ministrinë e Financave vlerësimin sipas standardeve të Bashkimit Evropian me metodologji me përkrahje financare nga ana e Komisionit Evropian, për ekonomin joformale, është dokument zyrtar është dokument i cili është hartuar në mënyrë goxha substanciale, është bërë mbi bazën e fuqisë vlerësuese reale të njerëzve jo të deklaruar dhe janë prodhuar statistikat që në mënyrë të drejtëpërdrejtë kanë tregu një ekonomi joformale në vendin tonë. Tani do të duhej nëse ka defekte në atë vlerësim të shikohet ai vlerësim jo të shkohet në vlerësime krejt të tjera. Ne, kur na ka lindur ideja për të diskutuar rreth statistikave po e zëmë, kemi pasur problem, nuk e dinim se sa i prodhon vendi ynë, nevojat me qumësht me produktet elementare, të cilat i kemi, sepse kemi pasur kundërthënie, kemi pasur Shoqatën e qumështit e cila deklaronte se na e plotësojmë 90% të tregut dhe nuk ka nevojë me importuar askush tjetër thoshte se të dhënat statistikore 50% dikush 30%. Në kuptimin e statistikave ekonomike na presin këto gjëra të cilat janë më të prekshme për jetën në përgjithësi për jetën e përditshme tonën të cilat janë gjëra të rëndësishme. Ndoshta struktura e statistikave dhe struktura e buxhetit nuk janë në harmoni, pse po e them se nuk janë në harmoni, sepse nëse hyjmë, unë jam munduar kur isha ministër i Financave me e diskutuar këtë çështje, sepse kam pasur kërkesa të shumta prej jush edhe ankime dhe unë nuk kam mundur me e kuptuar asnjëherë se sa është raporti i njerëzve të cilët merren me punë profesionale në statistika dhe zyrtarëve të cilët janë në kuadër të Agjencisë të Statistikave aty që punojnë. Dhe po ju them si ish- ministër i Financave që asnjëherë nuk kam qenë i bindur që duhet me e shtuar numrin e të punësuarve sepse keni pasur mundësi me bërë ristrukturim të brendshëm dhe jo me punësuar njerëz. Ka të dhëna shumë me defekte edhe në kuptimin e tregut të punës, jo për shkak tuajin, por për shkak të statistikave të cilat prodhohen diku tjetër dhe ka qenë një nismë atëherë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që të bëhet një përafrim i metodologjive, kalkulimit të statistikave të cilat duhet bërë. Statistikat sociale prej numrit të njerëzve të cilët janë të pensionuar prej atyre të cilët marrin pension ndoshta pa pasur të drejtën me marrë pension prej atyre që marrin ndihëm sociale, dhe prej atyre të cilët marrin dhe nuk kanë të drejtë të marrin të gjitha janë statistika të cilat duhet të trajtohen në mënyrë pak më të koordinuar. Por gjithsesi kur konsiderojmë që ka nevojë për buxhet, unë besoj që as Ministria e Financave, as Kuvendi dhe askush nuk heziton, por po ju them krejt përshtetësisht që me 200 mijë euro bëjmë zgjedhjen e problemeve, problemin duhet me zgjedhur në mënyrë strukturale të brendshme.

Raif Qela tha se duke e shqyrtuar nivelin e prodhimit të statistikave prej kësaj agjencie, ne vijmë në përfundim se ka edhe mungesa në disa prej të fushave, ndër të tjera të cilat na kanë penguar neve që ta kemi një pasqyrë më të qartë të asaj se nga po shkon zhvillimi ekonomik i Kosovës. Përkunder faktit shihet se edhe agjencia me mundësitë e veta ka punuar edhe kjo pasqyrohet edhe në publikimet e të dhënave të tyre, publikim i cili është pasqyruar mjaft mirë edhe në web- faqen e tyre dhe është një web- faqe mjaft funksionale, e cila të gjitha të dhënat i ka të grumbulluara, që i jep mundësi secili me i dhënë të dhëna, por këto janë të pamjaftueshme me vetë faktin se janë të pambulluara të dhënat të cilat nevojiten për të bërë qoftë një analizë për rrjedhat e më tutjeshme të ekonomisë, qoftë në fushat e tjera. Ju e përmendet çështjen e ndryshimit që keni bërë inicim të ndryshimit të Ligjit për Statistika zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe me qenë se kjo është fushë pikërisht është fushë e jona mbasi përmes këtij komisioni kalon ajo, ju lus që nëse nuk jeni të sigurt që nuk do të vijnë në shqyrtim kur të bëhet në këtë komision më mirë është që t'i jepni orientimet e përgjithshme se si t'i mbrojmë në ato amendamente që mendoni t'i bëni, se përndryshe ne nuk do të kemi argumente të bollshme që ato t'i shtyjme më tutje.

Agim Demukaj, Banka Botërore, tha se është një takim shumë i rëndësishëm, meqenëse e përmendet edhe ju, statistikën janë baza e politikave edhe në Kosovë, realisht mungojnë disa prej tyre. Në radhë të parë Agjencia e Statistikave ka arritur shumë, prej hiçit dhe neve nuk duhet mos me e harruar atë, sepse gjithçka që është krijuar në Kosovë është krijuar nga hiçi. Pra, unë dua ta them se duhet ta çmojmë punën e tyre dhe me shikuar se ku jemi dhe me i shikuar se ku gjinden të metat. Unë i kisha shtuar edhe një apo dy pika që mungojnë në statistika, të cilat janë shumë të rëndësishme dhe të cilat mungojnë pothuajse plotësisht, janë statistikën e varfërisë mos të harrojmë se raporti i fundit i varfërisë në Kosovë është publikuar në varfërinë e 2011 d.m.th. jemi duke biseduar për një kohë e cila ka kaluar para pesë vjetëve me qenë se luftimi i varfërisë është në mandatin e Bankës Botërore është diçka të cilën neve mundohemi me e përcjellë dhe është e pamundur me dalë më një raport të mirëfilltë, apo me e përcjell gjendjen deritashme pa pasur statistikë. Të dhënat e tjera, të cilat mendoj se mungojnë, janë statistikën e migracionit, arsyeja pse e përmendi se statistikën e migracionit është sepse Kosova më shumë shet fuqi punëtore jashtë, se sa që shet mallra edhe eksporti i shërbimeve të Kosovës d.m.th. janë disa të dhëna të cilat mungojnë plotësisht. Donatorët është e vërtetë që kanë ndihmuar edhe ndihmojnë edhe te Banka Botërore jemi në proces për me ju dhënë një 87 mijë euro e cila nuk është para e madhe, por ka zgatur tepër shumë! Mirëpo mendoj se donacionet nuk janë të mjaftueshme për shkak se nuk janë të qëndrueshme. Pajtohem me z. Beqaj që tha paraja 100, 200, 300 mijë nuk është para e madhe për shtetin nëse e përcaktojmë se kjo anketë apo kjo e dhënë nevojitet me një frekuencë më të shpeshtë, mirëpo, unë mendoj se duhet me e gjetur së bashku edhe ju si politikëbërës, edhe këta si ekzekutues të këtij mandati një model që për me i bërë më të qëndrueshme të dhënat që i përmenda.

Ruud Vermeulen, Fondi Monetar Ndërkombëtar, (FMN) tha se që duhet të ceket që është bërë mjaft punë nga ASK-ja, gjithashtu duhet të ceket që janë disa probleme statistikore dhe fusha se ku ne duhet të përqendrohemi më shumë janë statistikën nacionale. Nga ne ka pasur asistencë teknike për ASK-në në vitin 2015. Ne kemi bërë një diagnozë për statistikën nacionale dhe kemi dhënë rekomandime rreth përmirësimit të tyre. Janë tri pika kryesore ku ne do të dëshironim të shihnim disa përmirësime. E para është mungesa e publikimeve të statistikave

vjetore, në vitin 2015 prodhimi dhe publikimi i statistikave është bërë vetëm në muajin nëntor. Ne kur jemi takuar me Ministrinë e Financave dhe me partnerë të tjerë për të diskutuar rreth buxhetit të vitit të ardhshëm kemi hasur në probleme gjatë diskutimeve për shkak që statistikave të GDP-së kanë arritur atë nivel. Gjithashtu, ne kemi pasur edhe disa shqetësime rreth kualitetit të publikimeve statistikore tremujore. Ne jemi mirënjohës që ASK-ja ka filluar me publikimin e këtyre të dhënave tremujore, por për ne, si përdorues të këtyre të dhënave kemi shqetësime serioze sa i përket sigurisë së këtyre të dhënave dhe mungesat e gjata të publikimeve të këtyre të dhënave, kështu që ne kemi bërë disa rekomandime sa ju përket përmirësimit të këtyre të dhënave tremujore. Gjithashtu, një tjetër fushë që është vënë re nga anëtarët e komisionit është që mungesa e treguesve të lartë të frekuencave të të dhënave, sepse për ne që duam të dimë se ku qëndron ekonomia e vendit sot është e vështirë për të bërë atë konkluzion në bazë të dhënave që janë prodhuar dhe që janë publikuar. Në mungesë të treguesve të lartë të frekuencave të të dhënave, ne mbështetemi në treguesit prokurë, siç janë rritja e kredive dhe rritja e të ardhurave tatimore. Gjithashtu, ne mund të vërejmë që është shumë e lehtë që të bëjmë një analizë dhe një pikë për të dëshmuar se këto mungesa mund të jenë për shkak të kapacitetit të stafit për të prodhuar këto të dhëna, për arsye që janë shtatë persona përgjigjes, tre nga të cilët janë financuar nga Agjencia suedeze. Ne nuk kemi bërë ndonjë analizë konkrete se a duhet ristrukturim përbrenda stafit të ASK-së, apo nëse problemi qëndron te buxheti. Gjithashtu, duhet të cekim se një institucion si ASK, duhet të jetë në gjendje të operoj vetëm. Siç u cek edhe më herët, ASK operon nga fondet e shumta nga donatorët. Është e ditur se donatorët janë këtu për të ndihmuar ASK që të ketë përmirësime në rritjen e kapacitetit, por në fund ne duam të shohim ASK-në të jetë në gjendje të prodhojë ato statistika pa ndihmën e donatorëve. Konkluzioni që është bërë nga ne, Banka Qendrore, Ministria e Financave që jemi përdorues të këtyre të dhënave, rekomandojmë që të ketë përmirësim në kualitetin e statistikave dhe të ketë një komision i cili do të bëjë kontrollin e këtyre të dhënave para publikimit.

Sokol Havolli, (Këshilltar ZKM), tha se në fakt janë disa tema që një kohë të gjatë vazhdojnë të diskutohen të gjitha në funksion të nxjerrjes sa më të qëndrueshme, por edhe të besueshme të treguesve kryesor. Sepse përshtypja e të gjithë shfrytëzuesve të dhënave është se pikërisht të gjitha çështjet të cilat janë ngrit sot nga ju ballafaqohen nga probleme kryesore pasi që sa i përket statistikave të tregtisë apo të çmimeve mungesat janë më të vogla apo mund të themi se nuk ka fare mungesa. Mirëpo, te llogaritë kombëtare të tregu i punës, por edhe fushat e tjera të cilat janë të ndërlydhura, si prodhimi industrial përveç mungesave ekzistojnë edhe vonesat. Agjencia e statistikave në drejtim të rritjes të besueshmërisë së publikut edhe të shfrytëzuesve përfundimtar ndaj vetë këtyre treguesve pasi që kemi pasur shumë raste, por pas publikimeve të statistikave të GDP-së, por edhe të tregut të punës ka pasur diskutime mjaft të gjata rreth dallimeve në numra përkunder disa shpjegimeve të disa kolegëve të statistikave dhe vazhdimisht kanë qenë shpjegime të cilat nuk e kanë bindur publikun se qëndrimi i statistikave është ai që e shpjegon ai këtë dallim. Edhe në këtë drejtim e konsideroj se është e nevojshme që sa më tepër të jepet informacione deri në nivelin deri kur nuk mund të preket konfidencia e të dhënave statistikore të hapen të gjitha sa më tepër për publikun me qëllim që çdo kush që të bindet për një kohë të caktuar deri në rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj dhënave të agjencisë të statistikave. Deri sot në disa raste, dua të them kështu nën thonjëza Agjencia e statistikave, shpesh e ka befusuar publikun me publikimet e tyre dhe me statistikave të tyre pa pas mundësi që të diskutohen paraprakisht, jo në kontekst të ndikimit, por më tepër në kontekst të debatit për arsyeshmërinë e vet atyre rezultateve. Po ashtu ndoshta është mirë që Agjencia e

statistikave t'i rishikoj disa nga kompetencat ligjore, të cilat i ka në drejtim të prodhimit të statistikave. Këtë po e them duke e pasur parasysh pasi që i kemi dy institucione publike që prodhojnë statistika më voluminoze edhe Ministria e Financave dhe Bankës Qendrore. Megjithëse prapë po e theksoj këtu diskutimi është në katër- pesë fusha kryesore, ndërsa pjesa tjetër substanciale ose rreth 80% të statistikave të cilat publikohen gjejnë shfrytëzim të gjërë edhe janë të kualitetit mjaftë të mirë, mirëpo, diskutimi është vazhdimisht te tregu i punës, llogaritë kombëtare dhe industria.

Valentin Toçi, (Këshilltar ZKM), të nderuar deputetë unë vetëm do të doja që të kemi kujdes kur është çështja te krijimi i komunikimit, sepse atë funksion e kryen Këshilli Nacional i Statistikave. Dhe do të ishte mirë drejtori të na informojë pak mbi funksionimin dhe sa po arrihet koordinimi në atë këshill, si po funksionon këshilli i statistikave.

Isa Krasniqi, Agjencia për Statistika të Kosovës (ASK), duke filluar prej pyetjes së parë në zhvillimin e koordinimit në mes të institucioneve që prodhojnë statistika, por që janë shfrytëzues të mëdhenj të Agjencisë të statistikave, edhe mu ndërlidh pikërisht me këtë çështjen e fundit lidhur me Këshillin Statestikor, në bazë ligjore Agjencia e Statistikave është prodhuesi kryesor edhe koordinatori i prodhimit në sistemin statestikor të Kosovës dhe gjitha kjo tashti arrihet përmes këshillave të cilat i jep Këshilli statestikor i Kosovës. Këshilli statestikor është këshilldhënës nuk jep vendime, por jep këshilla. Në kuptimin e cilësisë pasi që cilësia është aq larg, mirëpo jemi duke bërë përpjekje që të jemi në trendin e integriteteve evropiane edhe në aspektin rajonal të jemi të krahasueshëm, sepse prodhojmë statistika dhe nuk kemi krahasim atëherë pse me i prodhuar ato statistika për arsye se krahasueshmëria është një parim mjaft i rëndësishëm. Ne duhet të prodhojmë statistika të cilat janë të krahasueshme me rajonin edhe me BE edhe me botën, andaj metodologjia rreth standardit duhet patjetër të implementohet në statistikat e Agjencisë. Në aspektet e ndryshimeve ligjore janë të potencuara aty cilat sepse janë edhe rekomandimet, principet që duhet patjetër t'i vendos në Ligji dhe të cilat i kemi vendosur është edhe aspekti i këshillit statestikor që të rritet funksionaliteti që Këshilli i statistikave të jetë më i pranueshëm dhe është propozuar me u shtuar numëri i anëtarëve të tjerë te Këshilli statestikor. Po ashtu janë edhe disa grupe që i kemi quajtur në propozim ligj, atje kemi propozuar që vetëm për GDP-në të jetë një grup si lloj komiteti që fillimisht të kemi diskutime dhe të harmonizohen gjërat. Të gjitha këto janë marrë nga përvoja, po e zëmë të Suedisë ku kemi bashkëpunim shumë të madh me statistikat e Suedisë, ku Skandinavia është jashtëzakonisht përpara edhe pak a shumë kemi marrë modele të tyre. Të llogaritë kombëtare të gjitha këto potencime të cilat u bënë mund të them se ekzistojnë ato probleme por ne i kemi adresuar edhe si t'i zgjedhim ato probleme. Në kuptimin e stafit ASK-ja në bazë të analizave të statistikave zyrtare edhe në bazë të rregullorës Qeverisë për sistematizimin e vendeve të punës në ASK e ka mbyllur atë procesin lidhur me vendet e punës. Në kuptimin e hapjes ne jemi të hapur për secilin individ shfrytëzues, institucion që në vazhdimsi me ardhur dhe me i shfrytëzuar të dhënat tona, në bazë të statistikave zyrtare ka me dhjetëra kërkesa që unë personalisht i kam aprovuar për me ardhur dhe me ju qasur të dhënave tona.

Kryetari në fund tha mendoj që e patëm një diskutim mjaft të dobishëm, unë pata dëshirë që në këto katër pesë çështje me u fokusuar i tërë diskutimi, por si shihet ka interesa të shumtë edhe për çështjet tjera. Ajo që duhet ndoshta të konkludojmë se pikërisht këto çështje që i diskutuam sot që ndërlidhen me statistikat mbi rritjen ekonomike, do të jenë më të shpeshta, sepse ato i

kemi lidhur me prodhimin industrial, punësimet dhe investimet përbëjnë prioritetet e politikave ekonomike. Sepse këto janë prioritetet e prioritetëve dhe na duhet të kërkojmë qoftë te statistikët, qoftë te aktorët e tjerë që e kontribuojnë prodhimin e statistikave, patjetër duhet t'i sigurojmë këto. Nuk mund të pretendojmë që të udhëheqim edhe më tutje politikën cilësore në qoftë se nuk i kemi këto statistika të bollshme me ritmin e frekuencës së kërkuar. Mandej ajo që mund të konkludojmë është që ne e përshëndesim rritjen e vëllimit të treguesve të publikimeve, por ajo që e kërkojmë ne nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, por edhe te aktorët e tjerë është që të ndryshojnë qasjen e prioritetit të publikimeve. Për ne, si Komisionin, si Kuvendin, si Qeverinë, statistikët mbi rritjen ekonomike prodhimin industrial, punësimin edhe investimet janë kyçe të rëndësishme prioritare. Prandaj ne na kërkohet që të shohim se çka mundet të ristrukturohet brenda entitit të statistikave d.m.th. prej disa sektorëve që ndoshta mund të kenë një frekuencë më të ngadalshme të publikimit edhe t'i kalojmë resurset për me i publikuar këto statistika. Nën dy, çka duhet të bëjmë në punësim. Dhe, nën tre, eventualisht rritja e buxhetit, por gjithmonë para se gjithash duhet t'i shohim në maksimum edhe rezervat e brendshme çka kemi, ristrukturimet e brendshme. Mirëpo, siç e tha edhe një kolegë, në qoftë se është punë për një sasi mjetesh për këto tregues, beso që duhet t'i gjejmë ato mjete dhe mos t'i lejojmë politikbërësit pa këta tregues të cilët janë të rëndësishme vitale, ky është qëllimi për të cilin jemi thirrur sot. Ne, si Komisionin, do t'i përgatitim disa rekomandime dhe t'i dërgojmë në Kuvend, dhe të mos mbesim pa këta tregues, sepse jemi 16 vjet mbas çlirimit, 8 vjet pas pavarësisë dhe ne duhet t'i kemi këta tregues, por nuk mund të vazhdojmë të arsyetohemi me mungesën e tyre.

Pas debatit Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Konkluzion

Komisioni do të nxjerrë Rekomandimet e posaçme lidhur me Agjencinë e Statistikave, në një nga mbledhjet e radhës.

4. Aktivitetet vijuese të Komisionit

Kryetari tha se që para vetes kemi një punë të madhe që na pret, për shkak se në seancën e radhës janë shtatë projektligje që do diskutohen në parim dhe mandej i kemi në trajtim. Andaj, kërkoj nga anëtarët e Komisionit, respektivisht kryesuesit e grupeve të punës që të bëjnë arsyetimin e projektligjeve në parim në seancë, si dhe mandej pas miratimit të kenë një angazhim të plotë në trajtimin e tyre.

Poashtu tha se duhet të fillojmë punën për shqyrtimin e projektligjit për investimet strategjike, ku tanime kemi mbajtur një dëgjim publik, dhe nga KDI presim një hulumtim, si dhe ndonjë ekspertizë.

Komisioni njëzëri e përkrahu propozimet e kryetarit.

5. Të ndryshme

Çështje vijuese

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit së lidhur me caktimin e ekspertit për të analizuar pakon e projektligjeve të energjisë, në bazë të listës së ekspertëve e propozoj prof. Ali Hamitin.

Komisioni njëzëri e përkrahu propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa